



Group for Legal
and Political
Studies



LEGAL
TRAINING
ACADEMY

SI TË QASEMI MË LEHTË NË MONITORIMIN E SISTEMIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL?



Manual i Monitorimit

Si të qasemi më lehtë në monitorimin
e sistemit gjyqësor dhe prokurorial?



Group for Legal
and Political
Studies



LEGAL
TRAINING
ACADEMY

Përmbajtja

Shkurtesat	5
Hyrje	5
Audienca e manualit	5
1. Qëllimi, parimet kryesore dhe llojet e monitorimit	6
1.1. Qëllimi i monitorimit	6
1.2. Parimet e monitorimit	7
1.3. Llojet e monitorimit	8
2. Përgjegjësitë e monitoruesit:	8
2.1. Përgjegjësitë teknike të monitorimit	8
2.2. Përgjegjësitë profesionale të monitorimit	8
3. Cilat janë pesë shtyllat kryesore të monitorimit?	9
3.1. Çka është mbledhja e të dhënave?	9
3.1.1. Si arrihet sigurimi i të dhënave përmes monitorimit?	9
3.1.2. Si arrihet sigurimi i të dhënave përmes rrugëve zyrtare?	10
3.1.3. Si arrihet sigurimi i të dhënave përmes kontaktit të drejtpërdrejtë?	13
4. Çka paraqet analizimi i të dhënave/informacioneve të mbledhura?	13
5. Çfarë duhet të përmbajë një raport monitorimi?	14
6. Çfarë duhet të përmbajë një analizë ligjore për rastin?	16
6.1. SHEMBULL: Struktura e një analize ligjore të rastit	16
7. Çka paraqet përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna?	17

Shkurtesat

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës



Hyrje

Ky manual shërben si udhërrëfyes për organizimin, metodologjinë dhe formën e monitorimit të rasteve gjyqësore në gjykatat në Republikën e Kosovës.

Përveç kësaj, manuali trajton rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e monitoruesit gjatë kryerjes së detyrave të tij, çështjet e metodologjisë së hartimit të raporteve të monitorimit, si dhe shpjegon në formë përmbledhëse aspektet si: mbledhja e të dhënave/informacionit, mënyrës së hartimit të analizave të shkurtëra e të gjera dhe veçanërisht në formë konkrete trajton tipet dhe llojet që e karakterizojnë punën e monitorimit.

Një aspekt tjetër me rëndësi që e vë në theks ky manual është edhe kodi i etikës së monitoruesit, i cili përmbledhet në 10 kategori të cilat shërbejnë për realizimin e një monitorimi të drejtë, korrekt dhe profesional.

Si përfundim, manuali trajton çështjen e mbikqyrjes së zbatimit të rekomandimeve të cilat ofrohen me rastin e publikimit të analizave ligjore e që kryesisht shërbejnë si një parametër vlerësimi për të matur efikasitetin dhe produktivitetin e monitorimit të zbatuar. Me anë të këtij veprimi, bëhet përcjellja e implementimit të rekomandimeve të cilat rrjedhin me rastin e hartimit dhe publikimit të analizave, si një mënyrë e mirë e pasqyrimin të ndikimit të rekomandimeve në sistemin e drejtësisë, konkretisht, analizimin e praktikës gjyqësore dhe faktin se sa është e mundur që një rekomandim i caktuar të zbatohet në realitet.

Audienca e manualit

Ky manual ka për qëllim prioritar ofrimin e ndihmës të organizatave joqeveritare, qytetarëve dhe grupeve joformale, të cilët synojnë monitorimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Përmes këtij manuali të përgjithshëm, lexuesit mund të përfitojnë njohuri bazike dhe profesionale të aktivitetit të monitorimit që nga parimet kryesore e deri tek impakti që mund të kenë dhe kontributi që mund të ofrojnë për shoqërinë, përmes këtij aktiviteti.

1. Qëllimi, parimet kryesore dhe llojet e monitorimit

1.1. Qëllimi i monitorimit

Monitorimi është njëri ndër mjetet kryesore në shoqëritë demokratike me anë të së cilës shtetet, shoqëria civile dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare kërkojnë të rrisin qasjen në drejtësi, shkallën e efikasitetit dhe transparencën brenda sistemit gjyqësor. Monitorimi mund të shihet edhe si mjet i fuqishëm në edukimin dhe trajnimin e juristëve mbi standardet vendore dhe ndërkombëtare. Në spektrin e ngushtë monitorimi mund të merret i kufizuar në vëzhgimin e procedurave gjyqësore publike dhe qëndrimin e sjelljet e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe zyrtarëve të tjerë të cilët janë fizikisht të pranishëm gjatë gjykimit. Mirëpo, këta janë vetëm hapat e parë që një monitorues duhet t'i ketë parasysh me qëllim të realizimit të këtij procesi.

Sidoqoftë, vëzhgimi i drejtpërdrejtë i procedurave gjyqësore përfshinë vetëm një pjesë të procesit të monitorimit. Në mënyrë që ky proces të jetë më thelbësor, një monitorues duhet të ketë parasysh që informatat e mbledhura nga monitorimi i drejtpërdrejtë nuk janë të mjaftueshme. Informatat tjera duhet mbledhur përmes burimeve të mëtejshme informacioni, dhe pastaj të krahasohen veprimet dhe sfidat konkrete me legjislacionin në fuqi. Në këtë mënyrë mund të analizohet nëse veprimet e ndërmarrura gjatë procesit gjyqësor janë në përputhshmëri me rregullativën ligjore të paraparë në aktet juridike përkatëse.



1.2. Parimet e monitorimit

Parimet kryesore konsiderohen:

► Parimi i objektivitetit

- Ky parim përcakton objektivitetin e monitoruesit gjatë procesit të monitorimit. Një monitorues duhet të rezervohet nga mendimet subjektive dhe punën e tij ta mbështes vetëm në legjislacionin në fuqi. Një monitoruesi i ndalohe të ndikohet nga rrethanat e rastit ose subjektet e caktuara në procedurë. Gjatë raportimit monitoruesi duhet të rezervohet nga shprehja e mendimeve personale dhe i njejt i duhet të ofrojë vetëm analizë ligjore të veprimeve gjyqësore që i monitoron.

► Parimi i mbrojtjes së të dhënave sensitive dhe konfidenciale

- Ky parim përcakton që monitoruesi gjatë kryerjes së detyrave të tij duhet të veprojë në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.¹ Një monitorues gjatë raportimit të aktivitetit të monitorimit duhet të ketë kujdes në evitim të publikimit të të dhënave personale të personave të përfshirë në rastin e monitoruar në të cilat mund të ketë qasje nga seancat e procedurës paraprake, seancat e mbyllura për publikun, informatat të cilat kanë të bëjnë me fazën e hetimeve, si dhe çfarëdo informacioni tjetër zbulimi i të cilit paraqet rrezik për vijueshmërinë e rastit konkret. Për më tepër, monitoruesi duhet të ketë kujdes të shtuar që përgjatë procesit të monitorimit dhe raportimit të evitojë çdo situatë me të cilën mund të dëmtohet integriteti dhe reputacioni i palëve.

► Parimi i mosndërrhyrjes në sistemin gjyqësor

- Ky parim përcakton që monitoruesi gjatë zhvillimit të aktivitetit të monitorimit duhet të respektojë pavarësinë e gjykatës dhe mënyrën se si gjyqtarët dhe stafi e implementojnë punën e tyre. Një monitorues duhet të evitojë çdo lloj situatë në të cilën do të mund të ndikonte në zhvillimin e procedurave gjyqësore e cila do të reflektonte si shkelje e parimit të pavarësisë së gjyqësorit.

1 Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i qasshëm online në linkun: <https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>

1.3. Llojet e monitorimit

Llojet kryesore të monitorimit konsiderohen:

► Monitorimi Sistematik

- Monitorimi sistematik paraqet përcjelljen e rasteve gjyqësore të natyrave të ndryshme (penale, civile, administrative) në mënyrë të vazhdueshme.

► Monitorimi Tematik

- Monitorimi tematik paraqet përcjelljen e rasteve gjyqësore që kanë të bëjnë me një natyrë specifike (vepra penale kundër detyrës zyrtare, krimet të organizuar, të natyrës administrative etj).

► Monitorimi Ad-hoc

- Monitorimi Ad-hoc paraqet përcjelljen e rasteve gjyqësore të ndryshme ku dyshohet se ka qasje selektive dhe trajtim jo të duhur nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë, pa u specifikuar në një natyrë të caktuar.



2. Përgjegjësitë e monitoruesit:

Përgjegjësitë e një monitoruesi:

2.1. Përgjegjësitë teknike të monitorimit

- Monitoruesi gjithmonë duhet të mbërrinjë me kohë në institucionin ku monitoron dhe të respektojë rendin e tij;
- Monitoruesi duhet të respektojë kodin e veshjes së institucionit ku monitoron;
- Monitoruesi duhet të mbajnë një mjet identifikues që e identifikon atë si monitorues;
- Monitoruesi duhet të silltet në mënyrë dinjitoze;

2.2. Përgjegjësitë profesionale të monitorimit

- Identifikimi, përzgjedhja dhe monitorimi i lëndëve, duke përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm të veprimeve gjyqësore;
- Monitorimin fizik të rasteve, përfshirë pjesëmarrjen në seanca gjyqësore, dhe mbledhjen e informacioneve të nevojshme;
- Raportimi i të dhënave të monitorimit duke respektuar legjisllacionin në fuqi;
- Analizimi i vendimeve gjyqësore dhe procedurave të ndjekura në rastet e monitoruara me qëllim të identifikimit, ekspozimit dhe përcjelljes së praktikave të gabuara dhe përmirësimit të tyre në këto gjykata;
- Ofrimi i rekomandimeve për gjykatat/prokuroritë për çështjet që duhet adresuar/përmirësuar;

3. Cilat janë pesë shtyllat kryesore të monitorimit?

1. Mbledhja e të dhënave
2. Analizimi i të dhënave
3. Raportimi i të dhënave
4. Ofrimi i rekomandimeve
5. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna

⚠ VËMENDJE: Hapi më i rëndësishëm të cilit duhet t'i kushtohet vëmendje maksimale nga ana e monitoruesit është mbledhja e informacionit ngase nga ky hap derivojnë hapat e tjerë!

3.1. Çka është mbledhja e të dhënave?

Mbledhja e të dhënave është hapi i parë i cili krijon urën lidhëse në mes të monitoruesit dhe gjyqësorit. Mbledhja e informacionit mund të bëhet nga:

- ▶ Prezenca e monitoruesit në sallën e gjyqimit;
- ▶ Sigurimi i të dhënave në rrugë zyrtare në kuadër të kërkesave për qasje në dokumente publike;
- ▶ Sigurimi i informacionit nga kontakti i drejtëpërdrejtë me punonjësit e sistemit të drejtësisë.

3.1.1. Si arrihet sigurimi i të dhënave përmes monitorimit?

Kur flasim për mbledhjen e të dhënave, duhet pasur parasysh se sigurimi i tyre paraqet hapin fillestar për procesin e monitorimit. Saktësia e të dhënave të mbledhura gjatë procesit të monitorimit ndikon drejtëpërdrejtë në kualitetin e monitorimit në tërësi, si dhe në hartimin e analizave ligjore dhe raporteve monitoruese në veçanti. Për të arritur deri tek të dhënat e sakta të lëndës, një monitorues duhet të tregohet vigjilent, të përcjell seancën gjyqësore me vëmendje të lartë.

Shembull:

- ▶ **Gjatë monitorimit të rasteve të natyrës penale, monitoruesi duhet të:**
 - marrë të dhëna mbi përbërjen e trupit gjykues dhe palët pjesëmarrëse në procedurë;
 - të kuptojë fazën e procedurës penale dhe aktivitetin gjyqësor të zhvilluar paraprakisht;

⚠ KUJDES: Monitoruesi duhet të bëj dallimin në mes të fakteve të rastit dhe pretendimeve të palëve të cilat nuk kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore. Për më tepër, monitoruesi duhet të tregohet i kujdesshëm lidhur me ballafaqimet e mundshme në mes palëve në procedurë dhe trupit gjykues dhe të reflektojë në raportimet e tij vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me rastin gjyqësor që e monitoron.

3.1.2. Si arrihet sigurimi i të dhënave përmes rrugëve zyrtare?

⚠ VËMENDJE: Sigurimi i të dhënave përmes rrugëve zyrtare bëhet përmes kërkesës për qasje në dokumente publike bazuar në Ligjin Nr. 06/L-081 Për Qasje në Dokumente Publike.²

Me identifikimin e rasteve të cilat duhet të monitorohen, monitoruesi përmes rrugëve zyrtare duhet të sigurojë:

- Kallzimin penal (nëse aplikohet);
- Aktvendimin për fillimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, pushimin e hetimeve dhe çdo dokument tjetër relevant për procedurën hetimore;
- Aktakuzën e ngritur;
- Aktvendimin e gjykatës për refuzimin ose aprovimin e kundërshtimeve të palëve lidhur me aktakuzën dhe provat e pranueshme;
- Aktgjykimin e shkallës së parë (nëse është i aplikueshëm);
- Ankesat e paraqitura nga palët (mjetet e rregullta juridike) lidhur me veprimet procedurale të prokurorisë dhe gjykatës (nëse janë të aplikueshme);
- Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë (nëse janë të aplikueshme);
- Kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike (nëse janë të aplikueshme).
- Vendimet e Gjykatës Supreme (nëse janë të aplikueshme).

3.1.1.1. Qasje në dokumente publike dhe legjislacioni në fuqi

E drejta për qasje në dokumente publike është e drejtë fundamentale e cila garantohej me kushtetutë, konventa ndërkombëtare, si dhe ligje. Kjo e drejtë garantohej me nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

E drejta e qasjes në dokumente publike në Kosovë, rregullohet me Ligjin Nr. 06/L-081 Për Qasje në Dokumente Publike, të hyrë në fuqi në korrik të 2019, me të cilin është shfuqizuar Ligji Nr. 03/L-215 Për Qasje në Dokumente Publike, i dhjetorit 2010.

- ▶ Kërkesat për qasje në dokumente publike apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin publik të kërkuar.
- ▶ Zyrtari përgjegjës brenda institucionit publik, me vendim, lejon ose refuzon qasjen në dokumente publike.
- Nëse institucioni publik nuk e disponon dokumentin e kërkuar, menjëherë, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi, detyrohet që ta informojë dhe udhëzojë kërkuesin për tek institucioni publik përkatës.

2 Ligji Nr. 06/L-081 Për Qasje në Dokumente Publike i qasshëm online në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

- Në rast se institucioni publik nuk ka njohuri për institucionin publik tjetër që mund të disponojë dokumentin, menjëherë, por jo më vonë se shtatë (7) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi, detyrohet që ta informojë për këtë kërkuesin dhe ta udhëzojë atë që t'i drejtohet Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Agjencia obligohet të konfirmojë nëse dhe cili institucion publik e disponon atë dokument, por jo më vonë se shtatë (7) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës, të njoftojë për këtë kërkuesin.
- ▶ Pas pranimit të kërkesës institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë.
- ▶ Kur dokumenti publik i kërkuar, i cili në bazë të një vlerësimi të arsyeshëm shihet të jetë i nevojshëm për mbrojtjen e jetës apo lirisë së një personi, institucioni publik detyrohet të ofrojë përgjigje brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve.
- ▶ Institucioni publik mund të vazhdojë afatin për marrjen e vendimit për qasje në dokumente publike më së shumti edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë, në rastet kur dokumenti duhet të kërkohet brenda një numri të madh të dokumenteve apo jashtë institucionit publik; ose me një kërkesë kërkohen një numër i madh i dokumenteve publike, nga e njëjta palë.



SHEMBULL: Formulari i një kërkesë për qasje në dokumente publike

Për: Gjykatës Themelore në Prishtinë, (varësisht nga kërkesa)

Nga: XY (emrin/e monitoruesit/es) – Emri i organizatës

Përschëndetje i/e nderuar, shpresoj se jeni mirë dhe se punët po shkojnë sa më mbarë!

Jam XY, monitorues/e në projektin për monitorimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës të udhëhequr nga XY, i financuar nga XY.

Po ju drejtohem me këtë kërkesë që të na informoni lidhur me aktgjykimet dënuese tek rastet e natyrës së korrupsionit, përkatësisht për informatat si në vijim:

1. Në sa raste janë shqptuar dënime plotësuese krahas dënimeve kryesore për periudhën qershor 2019-qershor 2021 nga gjykata përkatëse?

Njëkohësisht përmes kësaj shkrese ju lusim të na dërgoni aktgjykimet e përpiluara.

Këto informacione janë mjaft të rëndësishme për aktivitetin tonë monitorues dhe duke qenë se këto informacione burojnë nga dokumentet publike, ku qasja në to i garantohet secilit qytetarë në përputhje me legjislacionin në fuqi lidhur me qasjen në dokumentet publike, shpresojmë që këtë kërkesë ta trajtoni me prioritet, ashtu që të na informoni drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Mbesim me shpresë për përgjigjen pozitive nga ana juaj!

XY,

Prishtinë, Datë: xx/xx/xxxx

3.1.3. Si arrihet sigurimi i të dhënave përmes kontaktit të drejtpërdrejtë?

Atëhere kur nuk arrihet të sigurohen informata përmes kërkesës zyrtare, monitoruesi krijon:

- ▶ Kontaktin e drejtpërdrejtë me gjyqtarët dhe prokurorët e lëndëve specifike, nga i cili rezulton marrja e informacionit burimor dhe të sigurt.

4. Çka paraqet analizimi i të dhënave/ informacioneve të mbledhura?

Pas mbledhjes së informacioneve hapen rrugët për analizimin e të dhënave të siguruar të cilat drejtpërdrejt lidhen me përpilimin e raporteve dhe analizave të cilat mund të derivojnë nga të dhënat e grumbulluara.

Gjatë analizimit, monitoruesi fokusohet në dy fusha:

- ▶ Analizimi i veprimeve procedurale si dhe akteve juridike të nxjerra nga këto institucione;
- ▶ Analizimi i ndikimit të këtyre veprimeve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në sigurimin e zbatimit të së drejtës.

Gjatë analizimit, monitoruesi fokusohet në këto parime:

- ▶ Ushtrimin e funksionit në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- ▶ Marrjen e vendimeve në përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi:
 - Kushtetutën e Republikës së Kosovës³;
 - Konventat ndërkombëtare⁴;
 - Kodin Penal⁵;
 - Kodin e Procedurës Penale⁶;
 - Kodin e Drejtësisë për të mitur⁷;
 - Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve penale⁸;
 - Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë⁹;

3 Kushtetuta e Republikës së Kosovës online në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

4 Shembull: Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut në linkun:

https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

5 Kodi NR. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>, Kodi NR. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së

Kosovës në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834> Ligji NR. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2852>

6 Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>

7 Kodi Nr. 03/L-193 Kodi i Drejtësisë për të Mitur në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2698>

8 Ligji nr.04/L-149 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867> dhe Ligji nr. 05/L -129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

9 Ligji nr. 06/L-087 Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë në linkun:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8651>

- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit¹⁰.

Në këtë mënyrë, pas pranimit të informacioneve/të dhënave nga monitorimi, monitoruesi duhet të analizojë këto të dhëna në kuptim të respektimit të këtyre parimeve bazë. Pra, marrë parasyh rëndësinë e këtij lloji të legjislacionit, secili monitorues duhet të fokusohet në evidentimin e shkeljeve të të drejtave themelore të njeriut në procedurë gjyqësore. Për shkak se ky korpus përfshinë një numër të madh të të drejtave, monitoruesit duhet të shfaqin kujdes të theksuar në evidentimin e saktë të llojit të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Në një procedurë gjyqësore mund të shkelen disa të drejta themelore bashkarisht apo ndarazi. Ka raste specifike ku mund të shkelet parimi i gjykimit të drejtë, por jo edhe parimi i gjykimit në kohë të arsyeshëm, ndonëse legjislacioni parashih këto dy të drejta ngushtësisht të lidhura me njëra – tjetrën. Në këtë drejtim, pra, ekziston mundësia që gjykata të dështojë në ofrimin e gjykimit ku respektohet parimi i barazisë së palëve, kontradiktoritetit apo vlerësimit të duhur të provave, mirëpo gjykimi ka përfunduar në një periudhë të arsyeshme kohore. Duke qenë se këto principe bazë janë të përfshira në legjislacionet e shumicës së vendeve, duke përfshirë edhe Kosovën, atëherë duhet pasur parasysh se shkelja e normave konkrete procedurale dhe materiale me shumë gjasë paraqet edhe shkeljet të parimeve bazë.

⚠ VËMENDJE: Çdo monitorues duhet që gjatë analizimit të të dhënave të shikojë me kujdes nëse veprimet e ndërmarrura institucionale janë në përputhje me legjislacionin e fushës dhe parimet e procedurës gjyqësore.

5. Çfarë duhet të përmbajë një raport monitorimi?

Raporti i monitorimit përpilohet pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe duhet të përmbajë:

1. Datën e aktivitetit gjyqësor të zhvilluar;
2. Gjykatën në të cilën mbahet seanca gjyqësore;
3. Departamenti përkatës i gjykatës;
4. Emri i gjyqtarit/es të vetëm gjykues ose emrat e trupit gjykues;
5. Emri i prokurorit/es të shtetit i/e cili përfaqëson rastin;
6. Emrat e të akuzuarve ose inicialet e tyre;
7. Emrat e palës së dëmtuar (nëse aplikohet);
8. Përshkrimin e zhvillimeve në seancën gjyqësore;
9. Vlerësimin e monitoruesit lidhur me ligjshmërinë e veprimeve procedurale të ndërmarrura në seancë;
10. Përshkrimin e dispozitivit të aktakuzës;

10 Ligji nr. 05/L-096 Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12540>

Dëgjohen dy dëshmitarë në gjykimin për shpërlarjen e parave në vlerë mbi 65 mijë euro

Gjykata Themelore Prishtinë, 03 shtator 2021

Pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, këtë të premte, janë dëgjuar dy dëshmitarë në gjykimin ndaj të akuzuarit për shpërlarje të parave M.G., raporton Drejtësia Sot.

D.T. dhe A.B., në seancën e sotme të udhëhequr nga gjyqtari Musa Konxheli, janë përgjigjur në pyetjet e prokurorit Naim Abazi dhe avokatëve mbrojtës të të akuzuarit.

D.T, para trupit gjykues ka dëshmuar lidhur me blerjen e një prone nga tani i akuzuari M.G. Ai ka sqaruar se si ka rrjedhë kjo procedurë, që nga nënshkrimi i kontratës e deri tek vërtetimi i saj në gjykatë.

Ndërsa dëshmitari tjetër, zyrtari doganor A.B., para gjykatës ka dëshmuar për kontrollimin e veturës së të akuzuarit, në të cilën është gjetur shuma e parave në vlerë prej 65 mijë eurosh. Ai ka sqaruar në detaje këtë rrethanë, në përgjigjet që i dha për pyetjet e palëve në procedurë.

Pas dëgjimit të dy dëshmitarëve, gjyqtari Konxheli tha se gjykata do ta caktojë seancën e radhës pasi që eksperti financiar të hartojë një ekspertizë të veçantë nëse i akuzuari ka pasur burime legale për paratë që iu janë hasur në veturë gjatë kalimit të kufirit në Merdare.

Kujtojmë se çështja është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit, ngase të njejtit kishin konstatuar se nuk është respektuar neni 76 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i cili ka të bëjë me dënimi për bashkim të veprave penale, ngase nuk janë shqiptuar dënimet për secilen vepër veç e veç mirëpo është shqiptuar vetëm dënimi kumulativ për të dyja veprat për të cilat i pandehuri akuzohet.

Në shqyrtimi paraprak M.G., kishte arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Speciale, marrëveshje kjo e cila ishte aprovuar nga gjykata duke iu shqiptuar të njejtit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili me pëlqimin e të akuzuarit mund të zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 3600 euro, si dhe është dënua edhe me 1500 euro gjobë si dënim i veçantë duke iu konfiskuan kështu në mënyrë të përhershme edhe mjetet monetare në vlerë prej 65,450.00 euro.

Ndërsa pas kthimit në rigjykim i akuzuari nuk kishte pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë. Kurse gjatë fazës së kontrollimit të aktakuzës, sipas gjyqtarit Konxheli, Apeli me aktvendimin i tij ka kërkuar që procedura penale të zhvillohet vetëm për shpërlarje të parave dhe jo edhe për veprën penale të tregtisë së ndaluar.

Ndryshe, sipas aktakuzës fillestare, M.G. më 14.08.2020, ka kryer veprën penale, “Tregti e ndaluar”, pasi që është hasur duke ushtruar veprimtari ekonomike pa autorizim dhe pa leje përkatëse, në atë mënyrë që në veturën e tij janë gjetur mjete monetare të fshehura në valutën euro, të padeklaruara gjithsej gjashtëdhjetë e pesëmijë e katërqind e pesëdhjetë euro (65,450.00€).

Po ashtu, i pandehuri M.G. më 14.08.2020, ka kryer veprën penale “Shpërlarja e parave”, pasi që duke e ditur apo duke pas arsye të dijë se ishte duke bartur këto mjete monetare, të fshehura në automjetin e tij, ka tentuar që të fshehë ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vend-ndodhjen, sistemin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore.

Monitoruar nga XY

Nr. i lëndës: XY

6. Çfarë duhet të përmbajë një analizë ligjore për rastin?

Një analizë ligjore për rastin përmban:

- ▶ Përshkrimin e shkurtër të fakteve të rastit;
- ▶ Përshkrimi e veprimeve procedurale gjyqësore të ndërmarrura gjatë trajtimit të atij rasti;
- ▶ Shkeljet e identifikuara gjatë monitorimit;
- ▶ Analizimi i këtyre shkeljeve dhe ndikimi i tyre në rastin konkret;
- ▶ Përfundimi dhe rekomandimet për institucionet relevante.

⚠ VËMENDJE: Monitoruesi duhet të kujdeset që me rastin e hartimit të një analize të përdorë metodologji të caktuar të shkrimit që përfshin përdorimin e metodave analitike, krahasimore, dhe të aplikueshme.

6.1. SHEMBULL: Struktura e një analize ligjore të rastit

Një analizë ligjore që trajton një rast të monitoruar mund të përmbajë këtë strukturë:

▶ Hyrja:

- Pasqyrimi i problematikës që do të trajtohet në analizë:
 - Problemi kryesor;
 - Rasti ose rastet e përzgjedhura;
 - Metoda e hulumtimit (tregohet cilat dokumente janë analizuar, seancat që janë monitoruar).

▶ Baza ligjore:

- Shpjegimi i bazës ligjore që aplikohet në rastin konkret:
 - Neni i Kodit që përcakton që seancat janë publike;
 - Nenet përkatëse që përcaktojnë se si duhet të zhvillohet një procedurë gjyqësore. Në këtë pikë është qenësore që të reflektohet baza ligjore që përkon me rastin/dukurinë përkatëse.

Shembull: Nëse trajtohet fakti se rastet gjyqësore nuk po përfundohen me kohë, atëherë duhet elaboruar afatet ligjore të përcaktuara me ligjet përkatëse për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe parimet kushtetuese në këtë aspekt. Pra, baza ligjore varet drejtpërdrejt nga fakti se çka konkretisht trajton analiza dhe cila sferë ligjore mbulon atë pikë.

▶ Shkeljet ligjore të identifikuara:

- Shkeljet e identifikuara:
 - Argumenti kryesor dhe shpjegimi se pse është shkelje ligjore;
 - Argumenti 2 (nëse është identifikuar një shkelje e dytë);
 - Argumenti 3 (nëse është identifikuar një shkelje e tretë) etj., varësisht nga shkeljet e identifikuara.

⚠ VËMENDJE: Pjesa e argumentimit të shkeljeve ligjore është pjesa më e rëndësishme e një analize. Në këtë pjesë paraqitet një gërshetim i fakteve të rastit dhe bazës ligjore dhe konstatohet kur është gjetur shkelja e caktuar ligjore dhe arsyet pse konsiderohet shkelje e tillë.

Në këtë drejtim vie në shprehje aftësia e monitoruesit në interpretimin e duhur të dispozitave ligjore dhe argumentimin e bollshëm për të mbështetur konkludimin për shkelje ligjore.

► **Përfundimi:**

- Kjo pjesë paraqet një përshkrim të shkurtër të tërë analizës, të gjeturat e saj, dhe të gjitha konkludimet e analizës duke përfshirë vlerësimin final të ndikimit të veprimeve gjyqësore dhe prokuroriale në trajtimin e rastit/dukurisë konkrete.

► **Rekomandime:**

- Pjesa e rekomandimeve duhet të jetë e shkruar në mënyrë të qartë dhe koncize dhe duhet të përmbajë rekomandimet të radhitura për secilin institucion.
- Rekomandimet përpilohen si më poshtë:
 - **Rekomandimi 1** (rekomandimi i juaj nëse duhet të ndryshohet korniza ligjore);
 - **Rekomandimi 2** (rekomandimi i juaj për KGJK dhe KPK);
 - **Rekomandimi 3** (rekomandimi i juaj për prokurorët);
 - **Rekomandimi 4** (rekomandimi i juaj për gjyqtarët).

⚠ VËMENDJE: Monitoruesi me rastin e hartimit të analizave kujdeset që të shpërfaqë dukuritë negative të proceseve gjyqësore në veçanti, ose të pasqyrojë sfidat e përgjithshme të sistemit gjyqësor në përgjithësi.

7. Çka paraqet përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna?

Hapi i fundit i procesit të monitorimit është përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të cilat ofrohen në kuadër të punës së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

⚠ VËMENDJE: Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga monitoruesi për institucionet gjegjëse është mënyra më e mirë e pasqyrimin të ndikimit të tyre në sistemin e drejtësisë.

► Për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve, duhet ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Krijimi i një databaze të rekomandimeve të ofruara;
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve nga ana e institucioneve gjegjëse dhe reflektimi i tyre në databazën e të dhënave;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet gjegjëse të cilave u janë ofruar rekomandime.

SI TË QASEMI MË LEHTË
NË MONITORIMIN E SISTEMIT
GJYQËSOR DHE PROKURORIAL?